



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 8
Prishtinë, më 18 maj 2011, në orën 13:30
Ndërtesa e Kuvendit, sala N-225

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCIVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Ali Sadriu, Ramiz Lladrovci, Mursel Haljilji, Valbona Dibra, Armend Zemaj, Afrim Hoti, Muhamet Mustafa, Bali Muharremaj dhe Albert Kinolli.

Të ftuar: Lars Lage OLOFSSON, auditor i përgjithshëm, Vlora Mehmeti - ZAP, Enver Peci, Vehbi Behluli dhe Albert Avdiu – KGJK.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Fatime Qorri, koordinatore - KIPRED (staf mbështetës), Artan Venhari dhe Albert Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Ali Sadriu - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 10. 05. 2011 dhe më 11. 05. 2011;
3. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të Pasqyrave financiare të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, për vitin 2010;
4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 10. 05. 2011 dhe më 11. 05. 2011

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 10. 05. 2011 dhe më 11.05.2011.

3. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të Pasqyrave financiare të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, për vitin 2010

Kryesuesi – ZAP-i ka konstatuar se tri rekomandimet e viti të kaluar nuk janë adresuar fare nga KGJK-ja, si: menaxhimi i pasurisë, menaxhimi i parasë së imët dhe themelimi i Komitetit të Auditimit. Këto mbesin shqetësime edhe për vitin 2010. Fq. 10. 5.2, që kanë të bëjnë me pasuritë fikse nuk janë shpalosur saktësisht në Pasqyrat vjetore financiare. Regjistrimi kontabël i pasurisë nuk është prezantim i saktë dhe nuk janë shpalosur informatat shtesë për të pagueshmet. Shqetësim tjetër është procesi i prokurimit: Në fq. 12, ku flitet për dhënien e kontratave për furnizim dhe monitorim në objekte të gjykatës, kemi të bëjmë me një çështje që kërkon sqarim. Prokurimi nuk është bërë në harmoni me dispozitat ligjore, sepse kontrata është nënshkruar shumë më vonë, kurse punët kanë qenë të kryera. Në kontratat për riparimin e objektit në Prizren shihet është zgjedhur ofertuesi më i shtrenjtë, karshi ofertuesit më të lirë, që është shpallur si ofertues i papërgjegjshëm. ZAP-i ka konstatuar se i njëjti ka qenë i përgjegjshëm. Punimet e kryera po ashtu në Prizren duan sqarime. Pagesat e imta duhet t'ë trajtohen. Po ashtu duam garanci se do të themelohet Komiteti i Auditimit. I rekomandoi ZAP-it, që në rastet kur raporti i ZAP-it i referohet memorandumeve, do të ishte mirë që ato memorandume dhe materialet e tjera, t'ia bashkëngjitë raportit.

Lars Lage OLOFSSON - auditor i përgjithshëm – Opinioni është i qartë, pra të gjithë mund të besojnë në këtë raport. KGJK-ja ka bërë punë shumë të mirë për të përmirësuar situatën gjatë këtij viti. Por, ZAP-i është i shqetësuar për tri çështjet që janë përsëritur edhe në këtë vit. Çështja që është përsëritur shumë, është sistemi i prokurimit. Këtu nuk bëhet fjalë vetëm për disa gabime, por për gjithë procesin dhe për kontrollin ndaj tij. Në këtë drejtim KGJK-ja duhet të bëjë më shumë. Të gjitha rekomandimet e auditimit të brendshëm duhet të adresohen dhe të respektohen. Në përgjithësi shohim progres në KGJK.

Vlora Mehmeti – **ZAP** - Procesi i auditimit ka kaluar në dy faza: në fazën e përkohshme të auditimit janë kryer pjesërisht testime dhe ekzaminime. ZAP-i në këtë fazë ka dhënë një memo të përkohshme ku ka dhënë këshillat adekuate. Dhe në fazën përfundimtare ZAP-i ka nxjerrë raport final. Menaxhmenti i KGJK-së është zotuar se do t'i marrë të gjitha masat lidhur me të gjeturat e ZAP-it. Pasqyrat financiare të KGJK-së kanë pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale. Çështje e theksuar është shpalosja jo e saktë edhe jo e plotë që nuk ka ndikim material në pasqyrat financiare. ZAP-i ka konstatuar se prokurimi nuk është bërë gjithmonë në përputhje me ligjin. Këto të gjetura nuk janë materiale, por duhet adresuar që të mos përsëriten në të ardhmen, si në:

- Furnizimi pa kontrata me derivate të naftës. Vlera e furnizimeve për periudhën pa kontratë është përafërsisht 14 mijë euro.
- Dhënia e kontratës për furnizim me klima ofertuesit më të shtrenjtë. Komisioni vlerësues e ka shpallur të papërgjegjshëm një ofertues. Gjatë testimit ZAP-i ka konstatuar se ofertuesi ka qenë i përgjegjshëm. Kanë vazhduar procedurat e OSHP-së.
- Zhvillimi i procedurave të prokurimit pas kryerjes së punëve. Vlera e këtyre punimeve është 9 mijë e 950 euro.
- Parregullsi gjatë ndërtimit të objektit të Gjykatës për Kundërvajtje në Prizren. Sipas kontratës operatori duhet ta sigurojë vendin e ndërtimit. ZAP-i këtë dokument nuk e ka parë.
- Obligimet e pakryera ndaj furnitorëve. Vlera është 235 mijë euro.

- *Auditimi i brendshëm. ZAP-i ka konstatuar se auditimi i brendshëm objektiv e ka pasur testimin e të hyrave gjyqësore, si dhe menaxhimin e parasë së gatshme. ZAP-i ka rekomanduar që Njësia e Auditimit të fokusohet në fushat me rrezik të lartë, siç është prokurimi.*
- *Komiteti i Auditimit nuk është themeluar në vitin 2010.*

Enver Peci – KGJK – Puna e auditorit është ndihmesë për menaxhimin sa më të mirë të taksave qytetare dhe të parasë publike. KGJK-ja i ka adresuara disa rekomandime nga viti i kaluar. Disa prej tyre kanë mbet pa u adresuar dhe në të ardhmen KGJK-ja do të marrë masa sidomos në fushën e prokurimit, por edhe në fushat e tjera të rrezikshmërisë. KGJK-ja do të ndërmarrë masa, madje edhe me përgjegjësi subjektive, që të përmirësohen problemet që janë hasur.

Vehbi Behluli – KGJK – Opinioni i raportit është i pakualifikuar me theksim të çështjes. Janë bërë disa lëshime sa i përket regjistrimeve dhe shpalosjeve të pasurisë. Në këtë rast, vlerat më të larta të pasurisë, janë regjistruar vlera më të ulëta. Kjo ka ndodhur edhe më regjistrimin e pasurisë. Në këtë vit do ta rekrutojmë një zyrtar kompetent për këtë çështje. Rekomandimet nga viti i kaluar për paratë e imta, që i menaxhojnë gjykatat e Kosovës. Menaxhimi i parasë së imët bëhet nga secila gjykatë dhe ka raste kur edhe mund të ketë lëshime për shkak të rrethanave që krijohen në gjykatë. Mjetet nga paratë e gatshme shfrytëzohen nga gjykatat për shërbime emergjente. Rastet e mosrespektimit të procedurave lidhur me këtë janë raste të izoluara. Themelimi i Komitetit të Auditimit është bërë në muajin e tretë të këtij viti. Në planin vjetor të auditimit janë përfshirë fushat me rrezikshmëri të lartë. Buxheti është shpenzuar rreth 95%. Të hyrat e planifikuara rezultojnë rreth 97%, ashtu siç janë planifikuar. Kemi një përmirësim sa u përket investimeve kapitale:

- **Furnizimi pa kontrata me derivate të naftës.** Është bërë me qëllimin që të mos ngecë puna në gjykata. Paguesa është bërë sipas kontratës së vjetër.

- **Dhënia e kontratës për furnizim me klima ofertuesit më të shtrenjtë.** Kjo lëndë është vlerësuar nga KGJK-ja, mirëpo ka shkuar edhe në OSHP, që ka vendosur pozitivisht për të.

- **Zhvillimi i procedurave të prokurimit pas kryerjes së punëve.** Ka qenë një kontratë për largimin e gypave dhe ujësjellësve. Operatori i ka kryer punët, që nuk i ka pasur në kontratën bazë dhe autoriteti kontraktues është detyruar të shkojë me procedurë të kuotimit të çmimeve.

- **Parregullsi gjatë ndërtimit të objektit të Gjykatës për Kundërvajtje në Prizren.** Thuhet se disa punë të mbetura, që janë paguar, është fjala për mbjelljen e barit dhe të drurëve, nuk janë kryer për shkak të kohës, por ato janë kryer dhe KGJK-ja i dëshmon me fotografi. Disa pozicione janë zëvendësuar me të tjera dhe për këto ka dëshmi.

- **Ndërtimi i objektit të Gjykatave në Gjilan.** Këtu është bërë një lëshim nga vetë operatori dhe nga KGJK-ja, sepse është faturuar më shumë se është dashur. Faturimi është bërë në bazë të situatave. Operatori ekonomik gjatë ofertimit ka pasur 2% zbritje. Me kontratë është paraparë të marrë avans, sipas ligjit 15%, të cilin e ka marrë dhe kjo i është zbritur në secilën pagesë, duke e përfshirë edhe atë 2%. Gjatë faturimit operatori ekonomik ka bërë gabim - zbritjen e ka bërë jo nga situata aktuale, por nga ajo paraprake, kjo nuk është vërejtur. Kjo do të përmirësohet me faturën e parë që do ta kemi me këtë operator në këtë vit. Kontratat ende nuk ka përfunduar.

Kanë qenë edhe disa rekomandime të tjera si: rasti emergjent për një gjenerator. Në këtë rast KGJK-ja nuk ka pasur mjete të planifikuara dhe jemi detyruar t'i sigurojmë nga kategoria mallra dhe shërbime dhe nga disa regjistrime të shpenzimeve prej kodi ne kod brenda kategorive ekonomike. Ka përmirësime të dukshme në menaxhimin personelit me përjashtim të mirëmbajtjes së dosjeve. Mjetet e shfrytëzuara nga kategoria e subvencioneve dhe e transfereve, janë mjete që KGJK-ja i shfrytëzon nga të hyrat vetjake me memronadum me MEF-in, sepse nuk ka mjete të rregullta, fjala është për të dënuarit pa bazë. Borxhet, që janë pasqyruar në Pasqyrat financiare, janë për muajin dhjetor. Mbyllja e vitit bëhet në dhjetor, por faturat janë proceduar pas kësaj date.

Ramiz Lladrovci – Arsyetimet e KGJK-së janë të pakuptimta, sepse nuk mund të thuash se janë blerë materiale, sepse ka pasur nevojë urgjente për to. Këto duhet planifikuar në afatin njëvjeçar. Kështu krijohen mundësi për keqpërdorime.

Furnizimi me derivate pa kontratë nuk mund të arsyetohet. Kontrata ka afat njëvjeçar. Nëse ka pasur kontratë, KGJK-ja e ka ditur se kur përfundon ajo. Kështu do të shmangej mundësia e furnizimit pa kontratë. Kur flitet për kontratën për furnizim me klima dikush duhet të japë përgjegjësi, sepse kjo është shkelle e rëndë. Për pagesën për ndërtimin e objekti në Gjilan duhet të shtrohet pyetja: A e ka sjell operatori faturën me 167 mijë euro apo me 155 mijë euro? Kur flitet për blerjen e gjeneratorëve e dimë se shfrytëzimi i mjeteve prej një kodi në kodin tjetër është i ndaluar. Arsyetimi nuk është i saktë, në mënyrë që Komisioni ta vlerësoj nëse situata ka qenë emergjente ose jo.

Te e gjetura *“dhënia e kontratës për furnizim me klima ofertuesit më të shtrenjtë”* ZAP-i ka konstatuar se ofertuesi i diskualifikuar si i papërgjegjshëm ka qenë në rregull. Duhet të ketë përgjegjësi për këtë rast.

Valbona Dibra – E përgëzoj KGJK-në për opinionin e shfaqur, mirëpo të gjeturat janë shqetësuese. Rekomandoj që të njëjtat të mos përsëriten. OSHP-ja ka lejuar që KGJK-ja të procedojë me dy operatorë. Operatori që është diskualifikuar, a është ankuar në OSHP? Nëse po dhe ka rezultuar se ka qenë operator i përgjegjshëm, cili është veprimi i KGJK-së, duke pasur parasysh që operatori, që KGJK-ja e ka shpërblyer, e ka kryer shërbimin?

Shfrytëzimi i parasë së imët është përcaktuar saktë me rregullat financiare. Kjo nuk duhet të përsëritet dhe është diçka që mund të përmirësohet lehtë nga KGJK-ja. Blerja e gjeneratorit – prej kodit mallra dhe shërbime - si është lejuar? KGJK-ja ka mundur të kërkojë rialokim të mjeteve nga kategoria mallra dhe shërbime. Si ka shkuar ecuria e pagesës? Si është proceduar kjo lëndë dhe si jua ka lejuar këtë *free balance*?

Muhamet Mustafa – Sa është debatuar raporti i auditorit? A janë udhëhequr procedura administrative për njerëzit që kanë bërë lëshime? Vetëm kështu gabimet nuk do të përsëriten në të ardhmen.

Mursel Haljilji – ZAP-i ka konstatuar se në vitin 2009 janë dhënë 9 rekomandime. Lidhur me rekomandimet e adresuara ZAP-i është dashur të paraqesë si janë adresuar. Për rekomandimet e adresuara pjesërisht ZAP-i është dashur të paraqesë se në cilën fazë janë ato. Në fq. 12 thuhet “në krahasim me vitin paraprak”. Për këtë Komisionit i duhen të dhënat si ishte gjendja në vitin paraprak. Çfarë kanë qenë investimet kapitale në vitin 2009 dhe pastaj të prezantohen si ka ardhur deri te përmirësimi. Çfarë është bërë në përmirësimin e punës së gjykatave dhe a ka përparime? ZAP-i mund t'i ketë këto të dhëna, por Komisioni nuk i ka. Ata e kanë dërguar planin e realizimit, por nuk është konstatuar se janë zotuar dhe nuk janë specifikuar datat e realizimit. Në cilën fushë ka progres dhe në cilën ka mangësi?

Për kontraktimin e klimave është përzgjedhur ofertuesi më i shtrenjtë. Këtu nuk është mbajtur llogari për tatimpaguesit. Për ndërtimin e objektit në Gjilan janë paguar më tepër se 30 mijë euro. Nuk mund të bëhemi sikur s'ka ndodhur asgjë. Kjo është shqetësuese. Gjykatat janë të pavarura në shpenzime, mirëpo duhet të paraqiten në raporte sa dhe cila shumë është ajo që është shpenzuar. Propozoj të merremi më këtë çështje, sepse është shumë e rëndësishme që një institucion përfaqësues në Kosovë, siç është KGJK-ja, të respektojë dhe të funksionojë ligjshmërisht.

Vehbi Behluli – **KGJK** - Secila gjykatë e ka në dispozicion shumën e parave të imëta, që përcaktohet nga Këshilli Gjyqësor dhe nga rregullat e Thesarit.

Rastet kur shfrytëzohen paratë e imëta janë të rralla dhe të izoluara. Gjykata nuk i shfrytëzon paratë e imëta për blerjet që i ka në kontratë, por vetëm për shpenzime emergjente. Paratë e imëta janë përdorur në rastet kur një gjyqtarë për punë zyrtare është gjobitur nga policia për parkimin e veturës në vend të ndaluar. Sa i përket furnizimit me naftë, procedura e tenderimit është anuluar dy herë dhe nuk dihen arsyet. Sa u përket furnizimit dhe servisimit të klimave, nuk e di nëse ka pasur ankesa dhe kush është ankuar në OSHP, por është shqyrtuar e gjithë lënda dhe është vlerësuar pozitivisht. Ne kemi vendosur në bazë të atij vendimi. APP-ja e ka kundërshtuar, kurse OSHP e ka lejuar.

Sa i përket gjeneratorit, është dashur të bëhet një zgjedhje emergjente, sepse s'ka pasur kohë të bëhet kërkesë për transfer të mjeteve.

Kur janë kontraktuar punime në Prizren, nuk është ditur se ka gypa të qytetit. Gjatë punës në themele janë parë gypat dhe OE-ja i ka kryer edhe ato punë shtesë. Kur e kemi marrë lejen e punës, ne nuk kemi qenë të njoftuar nga Komuna që aty ka gypa. Pas punimeve OE-ja ka kërkuar t'i bëhet pagesa, që nuk ka qenë e paraparë në kontratë. Organet mbikëqyrëse e kanë miratuar të kryhet kjo pagesë.

Enver Peci – KGJK - Tha se KGJK-ja do t'i shqyrtojë të gjitha rastet dhe nëse është e nevojshme do të njoftojë edhe prokurorinë dhe agjencitë e tjera relevante. Rastet do të shqyrtohen veç e veç dhe secili do ta marrë përgjegjësinë. KGJK-ja do t'ia dorëzojë KMFP-së një raport për të parë sa janë përmbushur rekomandimet.

Vlora Mehmeti: Sa i përket implementimit të rekomandimeve nga viti i kaluar, fushat në të cilat është arritur progres janë: personeli, pagat e mëditjet, pjesa e buxhetit, planifikimi i buxhetit dhe shfrytëzimi i kategorisë për investime kapitale. Këto matje janë bërë në bazë të rekomandimeve të dhëna nga viti i kaluar.

Sa i përket furnizimit me derivate, ligji e parasheh miratimin e APP-së, po në këtë rast nuk ka pasur një të tillë.

Kryesuesi - Tha se është mirë të vërtetohet a është tërhequr ofertuesi më i lirë dhe pse është tërhequr. Kjo të hulumtohet dhe në raportin e ardhshëm të pasqyrohet.

Armend Zemaj - Prokurimi po mbetet fusha më e komplikuar, në të gjitha rastet. Raportet e auditimit në rastet ku ka dilema për implikime financiare duhet të kenë më shumë sqarime dhe të jenë më të përmbledhura. Këtu kemi të bëjmë me tri organe që janë krejtësisht të pavarura: OSHP, APP dhe një menaxher i prokurimit, që e kanë nënshkruar këtë vendim. Për ne nuk është e lehtë të përcaktojmë çfarë vendimesh të marrim.

Ramiz Lladrovci - Kërkojë nga auditori që këtë defekt të OSHP-së ta evidentojë dhe kur të vijë raporti i OSHP-së t'i kenë dëshmitë. ZAP-i duhet të kërkojë përgjegjësi edhe nga komisioni për vlerësimin e ofertave edhe nga OSHP-ja, sepse është keqpërdorur paraja publike.

Valbona Dibra – Ishte e mendimit se raportet që kanë “opinion të pakualifikuar” dhe ato me “theksim të çështjes” të mos procedohen për shqyrtim në seancë, për dallim prej atyre me “opinion të kualifikuar”, “të kundërt” apo me “mohim të opinionit”.

Armend Zemaj – Ndau mendimin me deputeten Dibra dhe shtoi se Komisioni në bashkëpunim me ZAP-in duhet ta përcjellë implementimin e rekomandimeve. Raportet që bëjnë fjalë për shkelje të rënda të trajtohen veçan dhe rekomandimet e Komisionit të jenë më specifike, përfshirë edhe ato që dalin nga Kuvendi.

Muhamet Mustafa - Nuk u pajtua me mendimin që në përgjithësi raportet me “opinion të pakualifikuar” të mos procedohen në mbledhje plenare për shqyrtim, sepse raporti me “opinion të pakualifikuar” tregon se Pasqyrat financiare janë reale, por transaksionet nuk janë të ligjshme. Përgjegjësi e Komisionit është që Pasqyrat janë paraqitur drejt dhe paratë janë shpenzuar drejt. Kjo duhet të varet prej situatës dhe prej dëmit që i është shkaktuar buxhetit.

Armend Zemaj - Përgjegjësi duhet të kërkohet në OSHP dhe në APP, sepse OE-ja nuk angazhohen ta fitojë tenderin nga OB-ja, por nga OSHP-ja dhe nga APP-ja.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike njëzëri e nxori këtë

Përfundim

- *Miratohet Raporti i auditimit të Pasqyrave financiare të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, për vitin 2010.*
- *Detyrohet Këshilli Gjyqësor i Kosovës që në afatin prej 60 ditësh ta njoftojë Komisionin për veprimet e ndërmarra lidhur me të gjeturat e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.*
- *Raporti nuk procedohet për shqyrtim në mbledhje plenare.*

4. Të ndryshme

a) Diskutim rreth shqyrtimit të Projektligjit për raportim financiar, kontabilitet dhe auditim

Kryesuesi – Tha se Komisioni në dy mbledhjet e kaluara është pajtuar ta krijojë një grup pune që do të merret me draftligjin për raportim financiar, kontabilitet dhe auditim, në mënyrë që Komisioni ta japë kontributin. Nuk shoh asnjë pengesë që ky grup pune t'i bashkëngjitet grupit punës të KBF-së.

Armend Zemaj – Ishte i mendimit, meqenëse KBF-ja e ka formuar grupin e punës dhe Kuvendi e ka ngarkuar këtë Komision për shqyrtimin e këtij Projektligji, atëherë KMFP-ja të mos merret fare me këtë Projektligj.

Muhamet Mustafa – Tha se KMFP-ja duhet të përqendrohet në pjesën e auditimit, ngase Projektligji ka të bëjë me raportim financiar, me kontabilitet dhe me auditim.

Valbona Dibra – Nuk sheh asnjë problem që grupi i punës i KMFP-së t'i bashkëngjitet punës së grupit të punës të KBF-së.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike nxori këtë

Përfundim

Kryesuesi i Komisionit t'i drejtohet me kërkesë Komisionit për Buxhet dhe Financa - që në shqyrtimin e Projektligjit për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim t'i ftojë edhe deputetët e grupit të punës të caktuar nga KMFP-ja.

b) Mbledhjet e Komisionit

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike nxori këtë

Përfundim

Mbledhjet e rregullta të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, mbahen ditën e mërkurë, në ora 13:30.

Mbledhja përfundoi në orën 15:30.

E Përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Ali Sadriu